



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim

Mbledhja nr. 90

Prishtinë, më 29.10.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Besian Mustafa, Milazim Salijaj, Isak Shabani, Ekrem Mustafa, Jetmire Vrenezi, Salih Zyba dhe Ganimete Musliu.

Munguan: Albena Reshitaj dhe Samra Ilijazi.

Pjesëmarrës të tjerë: nga mediat Diellza Gashi dhe Visar Krasniqi nga EO, përfaqësuesi nga RTK, Anitë Hakiqi-KDI, Driolë Biqkaj, Edina Grabovci, Besarta Ibrahimimi dhe Nora Lika-praktikante.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 8.10.2024;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-324 për financimin e menaxhimit të resurseve ujore;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 8.10.2024

Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi procesverbalin nga dt. 8.10.2024

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror

Kryetarja tha se Komisioni ka formuar Grupin e punës për këtë Projektligj, i cili ka përgatitë raportin me amendamente për komisionin, prandaj e ftoj kryesuesin e këtij grupi deputetin Ekrem Mustafa, ta paraqet raportin me amendamente.

Ekrem Mustafa, tha se Projektligji ka kaluar leximin e parë në Kuvend me 11.7.2024, ndërsa Komisioni në mbledhjen e mbajtur me 17.9.2024 e formoi grupin punues, në këtë përbërje: Ekrem Mustafa, kryesues dhe Jetmire Vrenezi dhe Isak Shabani, anëtarë.

Ky Projektligj i ka 30 nene dhe ka për qëllim të rregullojë statusin, mënyrën e organizmit, kompetencat e Ofruesit për Shërbimet e Navigacionit Ajror, si subjekt i pavarur juridik shtetëror në shërbim të interesit publik, për të siguruar infrastrukturën dhe shërbimet e navigacionit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

Në adresë të Komisionit për projektligjin nuk erdhi asnjë amendament nga deputetet e Kuvendit. Grupi i punës e ka shqyrtuar në 4 takimet e mbajtura së bashku me përfaqësuesit e Agjencisë së Navigacionit Ajror (ASHNA) dhe zyrën ligjore të MMPHI-së. Ndërsa, në mbledhjen e mbajtur me 23.10.2024 ka propozuar 33 amendamente, të cilat nuk janë përmbajtjesore, por më shumë janë teknike dhe i ftoi deputetët t'i votojnë.

Kryetarja, pasi që nuk pati diskutues të tjerë, i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 5 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

1. *Miratohen amendamentet e Grupit të punës për Projektligjin nr.08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror.*
2. *Raporti me amendamente të procedohet te komisionet e përhershme, sipas procedurës.*

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-324 për financimin e menaxhimit të resurseve ujore

Kryetarja e paraqiti për shqyrtim Projektligjin dhe tha se ky Ligj i ka gjithsej 32 Nene në 5 kapituj dhe ka për qëllim: të rregullojë mënyrën dhe burimet e financimit të menaxhimit të resurseve ujore në Republikën e Kosovës, pagesat ujore për shfrytëzimin e ujërave dhe shkarkimin e ujërave të ndotura, mënyrën e përcaktimit të lartësisë së këtyre pagesave dhe mënyrën e pagimit të pagesave ujore.

Pastaj, ajo shtoi se sipas opinionit për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave, zbatimi i Projektligjit nuk do të ketë kosto shtese buxhetore. Ndërsa sipas opinionit ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, Projektligji pjesërisht transponon dispozitat e acquis të BE-së. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit.

Pasi që nuk pati diskutues, kryetarja i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 5 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

Rekomandim:

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-324 për financimin e menaxhimit të resurseve ujore

5. Të ndryshme

Deputeti *Milazim Salijaj*, propozoi që të bëhet një raport përfundimtar i punëve të komisionit edhe në forma të broshurës, pasi që siç tha komisioni ka bërë një punë të madhe dhe se mediat nganjëherë nuk e kanë përcjell si dhe është hera e parë që mandati po shkon deri në fund.

Kryetarja tha se ideja e deputetit është që përveç raportit që zakonisht përgatitet, të bëhet edhe një broshurë të cilën mundemi më shpërnda edhe organizatave dhe individëve, mirëpo, kjo kërkon kosto shtesë dhe për këtë do të bisedoj më drejtorinë e mediave pasi që publikimi është në përgjegjësi të tyre.

Salih Zyba, propozoi që për mbledhjen e radhës të raportojë njëri nga ministrat e linjës MMPHI-së apo MBPZHR-së. Po ashtu, kërkoi që të informohet komisioni për procedimin e lëndës në gjykatë, si dhe pyeti a ka kërkesa nga OJQ-të.

Kryetarja, tha se kërkesën e fundit nga OJQ-të e kemi trajtua në mbledhje për vizitën në Lumëbardhin e Deçanit, mirëpo jemi dakordu që kryesuesja e Grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për ujëra, të caktojë vizitën. Nga kryetari i Komunës së Rahovecit, ka arritur një nismë, mirëpo ajo duhet të shkojë si nismë me nënshkrimin e 6 deputetëve apo me 10 mijë nënshkrime, kjo është procedurë sipas rregullores. Sa i përket raportit për dy pronat, ne e kemi shqyrtua në Komision është votua fillimisht me u dërgua në kryesi të Kuvendit dhe ajo e ka kthye se kjo lëndë nuk është për seancë. Pastaj në komision është diskutua edhe njëherë dhe është marrë vendim që të dërgohet në Prokurori. E kemi dërgua në prokurori në emër të Komisionit me nënshkrimin tim si kryetare e komisionit. Prokuroria e ka kthye përgjigjen se e ka marrë lëndën dhe është duke e shqyrtua. Ndërsa për raportimin e ministrave, jemi duke biseduar dhe po presim nga ministrat të na konfirmojnë kohën e përshtatshme se kur do të vijnë në raportim.

Isak Shabani, tha se nuk i di nga praktikat e mëhershme si është veprua, por a ka mundësi, pasi që kryetari i Rahovecit ka kërkuar, për ta paraqitur propozimin e tij në komision.

Kryetarja, në komision i ftojme vetëm përgjegjësit që na japin llogari neve si komision në takim kryetarët e komunave nuk raportojnë te ne sepse pastaj e hapim njëfarë rruge ku të gjithë kryetarët e tjetër mund të kërkojnë që të vijnë e të bëjnë propozime.

Ganimete Musliu, tha se në mbledhjen e kaluar ka kërkuar t'i dërgohet një pyetje AUV-it, në lidhje me inspektimin për mungesën e higjienës në disa markete në Prishtinë dhe pyeti nëse po cila është përgjigja e tyre. Çështje tjetër ajo ngriti siç tha “*çështja e helmimit të ujit të Badocit me Mangan*” dhe se përveç njoftimit që e bëjnë në faqen zyrtare që është shumë e pakët, duhet të kërkohej të sensibilizohet më shumë opinionin sepse jemi duke e dërgua qytetarin drejt një katastrofë me neglizhencën si institucione. Për arsye se nuk mjafton një cisternë me dërgua ujin qytetarëve, por institucionet duhet të jenë aktive të inspektojnë restorantet, kafiteritë që shërbehen me ujin e Badocit. Ky ujë nuk shërben as për larje, sepse qytetaret po mendojnë se uji kur vlohet mund të jetë i pijshëm. Për këtë është mirë më dalë si komision me një deklaratë dhe me ju bë thirrje inspektoratit për inspektime, është një shqetësim i madh sidomos në pjesën e Matit.

Kryetarja, tha se kemi nevojë për më shumë informata dhe se gjatë kësaj jave do ti shkruajmë AUV-it. Në ndërkohë kemi dërgua pyetje edhe për infektimin e lopëve me TBC, sa janë asgjësua dhe sa janë kompensua fermerët. Kemi marrë përgjigje me shkrim dhe do ju përcjellim të gjithë anëtarëve të komisionit.

Sa i përket çështjes së ujit të Badocit, neve si komision nuk na takon cilësia e ujit, pasi që është kompetencë e IKSHPK-së i cili i raporton Komisionit për shëndetësi. IKSHPK informon herë pas here për ujin me mangan. Sa i përket ujit nëpër kafiteri, në vendet ku kam qenë unë nuk kanë shërbye me ujë nëse e kanë pasur prej Badocit. Pra për lokalet edhe qytetaret kompetentë është IKSHPK dhe ne mundemi si deputetë vetëm me shpërnda thirrjen e këtij instituti.

Ganimete Musliu, shtoi se në të gjitha restorantet që e marrin ujin nga Badoci, shërbehet kafe, supa e gjella dhe ato të inspektohen gastronomitë, në ato zona ku ujin e marrin nga Badoci: “*Qytetarët duhet të informohen se uji nuk pihet, por ai ka problem edhe për larje, edhe pastrimin e dhëmbëve edhe për gjithçka tjetër. Janë pasojat shumë të rënda që i shkakton kontaminimi me mangan. Opinioni nuk e kemi sensibilizua sa duhet për mospërdorimin e këtij uji. Edhe mediat i lus që ta shpërndajnë këtë lajm sa ma shumë, që të vetëdijesohemi si shoqëri për mospërdorimin e këtij uji*”, si dhe kërkoi nga inspektorati të dalë dhe t'i inspektojë lokalet.

Salih Zyba, ndërhyri duke thënë se “*kjo thirrje e deputetes është e papranueshme*“ dhe kërkoi nga kryetarja që t’ia ndërpres fjalën deputetes me arsyetim se po e përdorë mbledhjen për qëllime të tjera.

Ganimete Musliu, kërkoi nga ai që mos t’ia ndërprerje fjalën, duke kërkuar edhe intervenimin e kryetares. Pastaj deputeti Zyba dhe deputetja Musliu debatuan me tone të ashpra se kush ka të drejtë e kush jo t’ia ndërpres fjalën në komisionin e deputetëve.

Kryetarja para se ta mbyll mbledhjen i kërkoi deputetes Musliu “*që mos ta përdorë mbledhjen, për shkak të fushatës*” dhe tha se kjo çështje nuk na takon neve por IKShKP-së, dhe kur ai lëshon mesazh për mos me e përdorë ujin, atë e marrin jo vetëm qytetarët por edhe gastronomia.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Fitore Pacolli-Dalipi,

Kryetare e Komisionit